



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. D. P Nr. Prot. 01/3486/11
Dep. _____ Br. Prot. _____
Dep. _____
Nr. i faq. _____ Data _____
Br. i faq. _____ Data _____
Nr. pages _____ Date _____

PRISHTINE 31.08.2011



AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	31.08.2011
REFERENC-Ë:	AKK-DP
PËR/ZA/TO:	z. Bujar Kuçi Menagjer i Zyrës Prokurimit Suharek
CC:	z. Blerim Kuçi Kryetari Komunës së Suharekës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Peqan faza I-rë".



I nderuar, z. Kuçi

Duke u bazuar në nenin 5 (pika 1.12) të Ligjit për Agjencinë nr:03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Peqan faza I-rë" me nr: prokurimi 624 111 30 521 në Komunën e Suharekës , ofron këtë:

Opinion

Zyra e prokurimit në Komunën e Suharekës, si autoritet kontraktues, në Dosjen e tenderit " Punë" të procedurës së hapur me nr.të prokurimit 624 11 130 521 e përgaditur më 10.08.2011 "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Peqan faza I-rë", në Pjesën, Seksioni II, Fleta të dhënave të tenderit të kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale - ka kërkuar, veç tjerash, sigurimin e Planit dinamik si dhe Garancionin në vite dhe ne Aneksin 6 Kriteret për dhënien e kontratës.

Zyra e prokurimit çuditrisht këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zberthyer në kuadër të dy pikave:

1. nr.2 te rubrika kategorit, ku ka paraparë: "Garancionin në vite pas përfundimit të punimeve për mirëmbajtje" pesha e këtij nënkriteri është 10 % te poentimit.
2. nr.3 te rubrika kategorit, ku ka paraparë: "Dinamika e kryerjes së punimeve (Plani Dinamik)" pesha e këtij nënkriteri është 20 % te poentimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.03/L-241 të Prokurimit Publik.

- Dispozitën e nenit 51 të LPP-së 03/L-241 dhe
- Dispozitën e nenit 52 të LPP-së 03/L-241.

Zyra e prokurimit të Komunës së Suharekës nuk ka respektuar edhe pjesën 5 të Udhëzimit administrative 04/2011/KRPP të datës 19.05.2011 I cili udhëzim parashehë që - asnjë kriter në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik nuk mundë të përdoren si kritere për dhënjen e kontratës.

Për ti evituar shkeljet e dispozitave të lartëcekura,

Rekomandojmë

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura me anë të kësaj shkrese ju rekomandojmë që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të lartëcekura në mënyrë që të respektohet Ligji Prokurimit Publik të Kosovës.

Me respekt.